

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-81/2015

**Prishtinë
23 maj 2018**

Në çështjen juridike të:

N. D.

Pala ankuese

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët, Beshir Islami, kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014 (lëndët e regjistruara në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA13561), të datës 30 prill 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 23 maj 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e N. D. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014, të datës 30 prill 2014, lidhur me lëndën e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA13561.
2. Anulohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/236/2014, i datës 30 prill 2014 për sa i takon lëndës të regjistruar me numër KPA13561.
3. Kërkesa e N. D, e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës nën numrin KPA13561, hidhet poshtë si e papranueshme për shkak se është marrë në mungesë të juridiksionit

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 27 shtator 2006, N. D. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur një kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP), ku kërkonte ri-posedimin ndaj ngastrës kadastrale nr. 2484/4, tokë e kultivuar e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 00.73.66 ha, që gjendet në vendin e quajtur “Jeloš”, Komuna Kadastrale Viti (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuara). Pala ankuese pretendonte se ishte bashkëpronar me ½ pjesë të barabarta i pronës së kërkuara.
Posedimi mbi pronën e kërkuar ishte humbur më 18 qershor 1999 për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e viteve 1998-1999.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese ka dorëzuar dokumentet vijuese:
 - Vendimin Trashëgimor nr. 62/63 që është i palexueshëm,
 - Kopjen e fletës poseduese nr. 1989 të lëshuar nga Departamenti i zhvendosur i Kadastrës dhe Gjeodezisë së Komunës së Vitisë më 21 shkurt 2000. Prona e kërkuar ishte e regjistruara në emër të palës ankuese dhe M. R .secili në cilësinë të bashkëpronarit me ½ pjesë të barabarta,
 - Aktgjykimin nr. 210/94 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë më 20 tetor 1994, me të cilin Ndërmarrja “Agromorava” nga Vítia, në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë, ishte obliguar të njëj të drejtën pronësore dhe t’ia kthej posedimin e pronën e kërkuar N. D. dhe M. R. Pasi që aktgjykimi ishte bërë i plotfuqishëm, Administrata e Departamentit të Kadastrës dhe Gjeodezisë do t’i kryente ndryshimet e nevojshme në Kadastër.
3. Më 22 korrik 2010, AKP-ja kishte bërë njoftimin e kërkesës. Vërtetimi i saktësisë së njoftimit ishte bërë përmes publikimit në gazetën njoftuese të AKP-së nr.1 dhe në Zyrën e UNHCR-it për Pronë. Ekipi njoftues e kishte lënë gazetën dhe listën në Komunën e Vitisë, në gjykatë dhe në zyrën Kadastrale.
4. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e kishte verifikuar negativisht aktgjykimin nr. 210/94 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë më 20 tetor 1994. Ai nuk ishte gjetur në Gjykatën Komunale të Vitisë dhe as në Gjykatën e zhvendosur të Vitisë dhe sipas zyrtarëve të Gjykatës Komunale të Vitisë, aktgjykimi nuk ishte i formës së prerë. Gjithashtu, fleta poseduese nr. 1989 ishte verifikuar negativisht në Departamentin për Kadastër të Vitisë.

5. Pala ankuese ishte informuar lidhur me rezultatet e Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së në lidhje me verifikimin e dokumenteve. Ai insistoi se Aktgjykimi nr. 210/94 ishte bërë i plotfuqishëm dhe se ai i kishte paguar taksat për të bartur të drejtën pronësore në emër të tij edhe pse ai nuk posedonte dëftesat.
6. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, përmes letrës zyrtare që i kishte dërguar palës ankuese, kishte kërkuar nga ai të dorëzonte dokumente shtesë me të cilët ai do mund të dëshmonte të drejtën e tij ndaj pronës së kërkuara. Njëkohësisht ai ishte udhëzuar se në rast të mos dorëzimit të dokumenteve të kërkuar kërkesat mund të refuzoheshin nga Komisioni (faqe 097 të dosjes së lëndës). Pala ankuese kishte qëndruar pasiv.
7. Më 30 prill 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) me vendimin e saj KPCC/D/A/236/2014, kishte refuzuar kërkesën. Në arsyetim të vendimit të saj (paragrafët 77-78), KKPK-ja konstatoi se aktgjykimi nuk është i plotfuqishëm dhe se të dhënat kadastrale në Viti tregojnë se ngastra të cilat janë të nën-ndara në ngastrën kadastrale nr. 2484 evidentohet në emër të palëve të tjera ndërsa prona e kërkuar ngastra kadastrale nr. 2484/4, nuk ishte gjetur. Prandaj, KKPK-ja konstatoi se paraqitësi i kërkesës nuk e kishte dëshmuar të drejtën pronësore mbi prona e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.
8. Më 13 tetor 2014, Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese. Më 30 tetor 2014 ai kishte paraqitur ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së është i jashtëligjshëm dhe i pasaktë sepse ai përmban shkelje të rëndë të procedurës, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe se kërkesat e tij për ri-posedimin e pronës së kërkuar nuk ishin vërtetuar në mënyrë të plotë.
10. Pala ankuese insistoi se prona e kërkuar ekziston dhe se kjo mund të dëshmohej me dokumentet që ai tashmë kishte dorëzuar (duke iu referuar fletës poseduese nr. 1989 dhe Aktgjykimit nr. 210/94).
11. Pala ankuese ka theksuar se AKP-ja përmes vendimit të saj KPCC/D/C/184/2012, të datës 14 dhjetor 2012, kishte vendosur pozitivisht për kërkesën e tij KPA13562 e cila ishte paraqitur për ngastrën kadastrale nr. 2483/3. Kjo ngastër kadastrale është pjesë e fletës poseduese nr. 1989 njësoj si dhe prona e kërkuar.
12. Ankesës ai ia bashkëngjiti dokumentet vijuese:
 - Kopjen e fletës poseduese nr. 4/94 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër dhe Gjeodezi i Komunës së Vitisë më 26 dhjetor 1994, ku prona e kërkuar ishte në emër të palës ankuese dhe M. R. secili me ½ pjesë të barabarta,
 - Kopjen e fletës poseduese nr. 1989 të lëshuar nga Departamenti i zhvendosur i Kadastrës dhe Gjeodezisë i Komunës së Vitisë më 21 shkurt 2000. Prona e kërkuar evidentohet në emër të palës ankuese dhe M. R. secili me ½ pjesë të barabarta,
 - Shkresën nr. 02-672/8 të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Kadastrës më 6 qershor 2007 ku përshkruhen koordinatat lidhur me prona e kërkuara,
 - Skicën e matjeve lidhur me ngastrën kadastrale 2484/4 të lëshuar nga Kadastra Komunale e Vitisë më 17 janar 2014. Matjet ishin kryer pas kërkesës së Gjykatës Themelore të Gjilanit, dega në Viti.
13. Në fund, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme të miratoj ankesën e tij si të bazuar dhe të bie një aktgjykim me të cilin ajo njeh të drejtën e palës ankuese mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor:

14. Gjykata Supreme shqyrtoi Vendimin e kundërshtuar dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese konstatoi se ankesa është e pranueshme.
15. Vendimi i KKKPK-së duhet të anulohet *ex officio* pasi që lënda nuk bie brenda juridiksionit të saj. KKKPK-ja nuk është dashur të vendos mbi meritat e lëndës por është dashur ta hedhë atë poshtë – neni 11.4 (b) i Ligjit nr. 03/L-079. Pasi që kjo nuk është bërë, Vendimi i kundërshtuar duhet të anulohet *ex officio* dhe kërkesa të hedhet poshtë.
16. Para së gjithash, pala ankuese thekson se KKKPK-ja e kishte miratuar kërkesën e tij nr. KPA13562 e cila ishte paraqitur për pronën e cila është e përfshirë në Fletën Poseduese nr. 1989 si dhe në Aktgjykimin nr. 210/94 njësoj si dhe prona e kërkuar. Në fakt, kërkesa nr. KPA13562 ishte miratuar nga KKKPK-ja përmes Vendimit të saj KPCC/D/C/184/2012, të datës 14 dhjetor 2012.
17. Në arsyetimin ligjor të Vendimit (paragrafi 14-16) theksohet ... *për të mbështetur kërkesën e tij paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar dokumente të ndryshme përfshirë fletën poseduese nr. 1989 të verifikuar pozitivisht e cila është siguruar nga të dhënat kadastrale të zhvendosura në Serbi...*
18. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se fleta poseduese nr. 1989 e lëshuar nga Regjistri Kadastral i zhvendosur në Serbi nuk duhet të merret parasysh nga Komisioni, e aq më tepër për faktin se zyrtarët e Regjistrat Kadastral të zhvendosur në Serbi nuk ishin në gjendje të gjejnë *ex officio* dokumentet mbështetëse për të konstatuar bazën për regjistrimin e pronës së kërkuar në emër të palës ankuese.
19. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës përmbahet nga ndërmarrja e ndonjë veprimi lidhur me Vendimin e Komisionit KPCC/D/C/184/2012 pasi që kundër Vendimit nuk është paraqitur asnjë ankesë në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 i cili parasheh që pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.
20. Prandaj, Gjykata Supreme do të bëjë një përmbledhje të shkurtër të arsyeve se përse KKKPK-ja nuk ka juridiksion për të gjykuar lëndët në fjalë.
21. Sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, pala ankuese ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë apo të drejtën e shfrytëzimit mbi pronën private të kërkuar, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore mbi pronën në fjalë për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
22. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë një verifikim negativ të dokumenteve mbi të cilët pala ankuese mbështet kërkesat e tij. AKP-ja nuk ka qenë në gjendje të siguroj *ex officio* asnjë provë që mbështet kërkesat e palës ankuese.
23. Bazuar në Aktgjykimin nr. 210/94 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë më 20 tetor 1994, Ndërmarrja “Agromorava” në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë ka qenë e obliguar të njeh të drejtën pronësore dhe të bëjë kthimin e posedimit mbi pronën e kërkuar tek pala ankuese dhe M. R. Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, administrata e Departamentit të Kadastrës dhe Gjeodezisë kryen ndryshimet në Kadastër. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se aktgjykimi përmban vulën që tregon se ai ishte bërë i plotfuqishëm më 7

nëntor 1994 edhe pse vula nuk është plotësisht e dukshme. Megjithatë, aktgjykimi i njëjtë nuk ishte gjetur në Gjykatën Komonale të Vitisë dhe as në Gjykatën e zhvendosur në Republikën e Serbisë.

24. Sipas nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (Gazeta Zyrtare nr. 6/80), (i aplikueshëm në kohën kur ishte lëshuar Aktgjykimi nr. 210/94), e drejta pronësore fitohet nga vet ligji (në këtë rast Aktgjykimi nr. 210/94), në bazë të punës juridike (bartjes së ligjshme) apo përmes trashëgimisë.
25. Megjithatë, neni 33 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (GZ e RSFJ-së, nr. 6/80), e përcakton se mbi bazën e punës juridike e drejta e pronësisë mbi pronën e paluajtshme fitohet me regjistrimin në "librin publik"(Librin e Kadastrës) ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme që parashihet me ligj.
26. Prona e kërkuar nuk u gjet në Departamentin për Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë duke dëshmuar kështu se azhurnimet e përshtatshme në Aktgjykim nuk ishin kryer. Kjo do të thotë se Aktgjykimi nr. 210/94 nuk ishte ekzekutuar gjatë periudhës 1994-1999.
27. Për më tepër, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se prona e kërkuara ishte subjekt i gjyqimit pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
28. Gjykatës i ishte siguruar Vendimi AC-i-14-0142 i lëshuar më 14 prill 2016 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Vendimi Kadastral nr. 603/2016 i lëshuar nga Departamenti i Kadastrës së Komunës së Vitisë më 7 tetor 2016.
29. Sipas Vendimit AC-i-14-0142 të lëshuar më 14 prill 2016 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit:
 - pala ankuese është pranuar në procedurën para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të Kosovës, me statusin e palës së konsoliduar ndërgjyqëse dhe palët përgjegjëse në kërkesë (Ndërmarrja Shoqërore "Agromorava" dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit) ishin bashkuar për të ndërmarr çdo veprim në lidhje me pronën e kërkuar deri në zgjidhjen përfundimtare të kontestit lidhur me regjistrimin e të drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar sipas Aktgjyqimit Nr. 210/94.
30. Sipas Vendimit Kadastral nr. 603/2016, ishte aprovuar kërkesa e palës ankuese dhe M. R. për regjistrimin e pronës së kërkuar në emrat e tyre.
31. Bazuar në të gjitha këto që u thanë më lartë, Gjykata Supreme gjen se prona e kërkuar ishte regjistruar si pronë shoqërore gjatë periudhës 1998-1999.
32. Vërtetimi dhe mbrojtja e të drejtave pronësore ndaj pronave shoqërore dhe/ose pronave shtetërore nuk është në juridiksionin e KKPK-së, respektivisht Kolegjit të Apelit të AKP-së.
33. Gjykata Supreme konstaton se Komisioni ka vendosur gabimisht dhe në mënyrë të paligjshme kur ka lëshuar Vendimin, pasi që ai nuk ka pasur juridiksion mbi kërkesën. Prandaj, ankesa e palës ankuese pranohet, vendimi i KKPK-së anulohet dhe kërkesa duhet të hedhet poshtë në përputhje me nenin 13.3 (a) të Ligjit nr. 03/L-079.
34. Bazuar në atë që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 198.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, gjyqtare e EULEX-it

Ragip Namani, gjyqtar

Timo Eljas Torkko, referent i EULEX-it